



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 695 Akti

Nr. 702 Vendimi  
Tiranë, më 27.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 27.9.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Agron Bushati**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.12.2020 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në datën 18.12.2020, anëtarja/relatorja e çështjes Genta Tafa (Bungo) ka paraqitur dorëheqjen nga çështja me arsyetimin e ekzistencës së konfliktit të interesit, të paktën në dukje.

4.1 Trupi gjykues i ngritur me vendimin nr. 72, datë 21.12.2020, të Komisionit, në datën 23.12.2020 ka vendosur mospranimin e kërkesës.

5. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ.

6. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Agron Bushati, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të tij, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e

veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**10.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

**11.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**12.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati.

**13.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**14.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

**15.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 19.9.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes.

<sup>1</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 10.4.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2023.

16. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 20.9.2023, ndërsa më 25.9.2023 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

17. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

## II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 25.9.2023.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.9.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

20. Subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Z. Agron Bushati ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

22.1 Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>5</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 25.9.2023.

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**23.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuara pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**24.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Subjekti ka nisur detyrën në vitin 2001 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**25.** Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti nuk ka deklaruar pasuri në pronësi, por ka deklaruar të ardhurat si vijon:

a. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë, me detyrë hetues, periudha 1.1.1994 – 16.9.1995. Shuma: 250,619 lekë.

Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, për të provuar të ardhurat e mësipërme.

b. Prokuroria Ushtarake e Rrethit Shkodër, me detyrë oficer i policisë gjyqësore, periudha 16.9.1995 – 31.3.2001. Shuma: 1,599,831 lekë.

Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të provuar të ardhurat e mësipërme.

c. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me detyrë prokuror, periudha 1.4.2001 – 31.12.2016. Shuma: 14,055,886 lekë.

Subjekti ka depozituar vërtetimet nr. \*\*\*, datë 25.10.2016 dhe nr. \*\*, datë 9.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të provuar të ardhurat e mësipërme.

d. *Overdraft*<sup>6</sup> në shumën -290,376 lekë, në Bankën Kombëtare Tregtare.

---

<sup>6</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie, datë 25.1.2017, nga BKT-ja.

## Hetimi<sup>7</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

**26.** Në lidhje me të ardhurat e deklaruara subjekti ka deklaruar sipas vërtetimeve përkatëse.

Në lidhje me *overdraft*-in e deklaruar, nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në BKT rezulton se subjekti ka gjendje në datën 27.1.2017 shumën -285,139.32 lekë, ndërsa në datën 30.12.2016 gjendja është -290,376.32 lekë.

**26.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nuk kanë rezultuar dyshime apo paqartësi në lidhje me të ardhurat e deklaruara.

**27. Automjet<sup>8</sup> tip “Mercedes-Benz E\*\*\*”,** me targë SH \*\*\* E, prodhim i vitit 1991, me vlerë 150.000 lekë. Subjekti është shprehur: *“Automjeti është blerë nga babai im S.K.B, invalid i klasit A - i verbër dhe është në përdorim nga ana ime”*.

## Hetimi<sup>9</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

**28.** Babai i subjektit, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.9.2014, ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë SH \*\*\* E, në vlerën 150,000 lekë. Në kontratë përcaktohet se z. S B për arsye moshe dhe sëmundjeje është i verbër e nuk mund të shkruajë, prandaj autorizon djalin e tij Agron Bushati, i cili pranon të nënshkruajë. Bazuar në librezën e verbërisë konstatohet se babai i subjektit është i verbër i grupit të parë që nga data 30.9.2011.

Për sa më sipër rezulton se kontrata është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e personit të autorizuar.

**29.** Nga deklarata doganore Import 4, datë 7.7.2004, rezulton se automjeti është blerë në shumën 1,200 euro (147,672 lekë<sup>10</sup>) dhe janë paguar detyrime doganore në shumën 186,000 lekë. Nga të dhënat e AMF-së rezulton se policat për këtë automjet janë në emër të babait të subjektit, z. S.B.

**30.** Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka sqaruar se mjeti është blerë nga familjarët e tij (prindërit dhe vëllai) për plotësimin e nevojave të familjes dhe kryesisht për ato shëndetësore të babait të tij. Për këtë arsye është vënë në emër të babait si kryefamiljar. Mjeti është përdorur nga ai dhe vëllai i tij në varësi të nevojave familjare që kanë pasur. Si burim i të ardhurave për blerjen e automjetit është shuma e përfitur nga nëna e tij R.I.B me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2012, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të ardhurat e vëllait të tij G.B, i cili ka jetuar dhe vazhdon të jetojë me prindërit edhe aktualisht.

**31.** Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes:

a. Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2012, e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, drejtuar znj. R.B.

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, nga BKT-ja.

<sup>8</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) vërtetimin nr. \*, datë 23.1.2017, nga DPSHTRR-ja Shkodër; (ii) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.9.2014; (iii) certifikatë pronësie të automjetit me targë SH \*\*\* E; (iv) deklaratë doganore; (v) vërtetim nr. \*, datë 23.1.2017, nga DPSHTRR-ja Shkodër.

<sup>9</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rugor; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2022, nga DPSHTRR-ja; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2023, drejtuar ISSH-së, Drejtoria e Arkivit Qendror; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2022, e ISSH-së, Drejtoria e Arkivit Qendror; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2023, drejtuar noterit publik, znj. V.H; kthim përgjigjeje e noterit publik, znj. V.H.

<sup>10</sup> Kursi i këmbimit 123.06.

Në këtë shkresë, AKKP-ja njofton nënën e subjektit se, pasi shqyrtoi kërkesën për kompensim të sipërfaqes 2,133.2 m<sup>2</sup> brenda pasurisë me nr. \*\*\* me sipërfaqe të përgjithshme 6,158 m<sup>2</sup>, ndodhur në z. k. \*\*\* Shkodër, që preket nga ndërtime informale, vendosi kalimin e kështit të kompensimit 47% në vlerën 1,420,355.67 lekë në numrin e llogarisë bankare në NBG Bank.

Kalimi i kësaj shume konfirmohet edhe nga nxjerrja e llogarisë së nënës së subjektit në ABI Bank<sup>11</sup>, nga ku rezulton se në datën 6.6.2012 është depozituar shuma 1,419,855.67 lekë.

- b. Deklaratë nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021, mbi ekstraktet e deklarimeve të tatimit për vitet 2012 – 2020 të vëllait të tij G.B. Bashkëlidhur kësaj deklarate janë depozituar deklaratimet mbi tatimit të nxjerra në rrugë elektronike nga sistemi C@TS:

**Tabela nr. 1**

Viti	Fitim i tatueshëm	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	Fitimi neto
2012	1,423,140.00	142,314.00	1,280,826.00
2013	2,188,895.00	218,890.00	1,970,005.00
2014	2,613,099.00	195,982.00	2,417,117.00
2015	2,571,839.00	192,888.00	2,378,951.00
2016	4,667,110.00	233,356.00	4,433,754.00
2017	3,129,520.00	-	3,129,520.00
2018	4,104,736.00	205,237.00	3,899,499.00
2019	6,840,190.00	342,010.00	6,498,180.00
2020	6,353,279.00	317,664.00	6,035,615.00
<b>Totali</b>	<b>33,891,808.00</b>	<b>1,848,341.00</b>	<b>32,043,467.00</b>

### 32. Analiza financiare

Komisioni ka kryer analizën financiare për të provuar mundësitë financiare për blerjen e këtij automjeti.

**Tabela nr. 2**

	2012 – 15.9.2014
<b>Pasuria</b>	<b>1,357,343.78</b>
Automjet (në përdorim nga subjekti )	150,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	1,207,343.78
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuria neto</b>	<b>1,357,343.78</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>2,513,024.69</b>
Të ardhurat e babait	409,150.00
Të ardhurat e nënës	358,987.00
Të ardhura nga kthimi dhe kompensimi i pronave	1,721,559.00
Të ardhurat nga interesat bankarë	23,328.69
<b>Shpenzime</b>	<b>891,141.00</b>
Shpenzime jetike	891,141.00
TIMS	0.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>264,539.91</b>

Në analizë janë përfshirë:

<sup>11</sup> Kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, e ABI Bank.

- a. të ardhurat e përfituara nga prindërit në vlerën 768,137 lekë për periudhën 2012 –15.9.2014, të evidentuar nga nxjerrjet e llogarive bankare;
- b. të ardhura nga kthimi dhe kompensimi i pronave në vlerën 1,721,559 lekë, të përfituara nga nëna e subjektit, përkatësisht në vitin 2012 në vlerën 1,419,855.67 lekë dhe në vitin 2013 në vlerën 301,703.33 lekë, të evidentuara nga nxjerrjet e llogarive bankare;
- c. të ardhurat nga interesat bankarë në vlerën 23,328.69 lekë të evidentuar nga nxjerrjet e llogarive bankare;
- d. shpenzimet jetike janë përlllogaritur për 2 persona.

**33.** Nga analiza financiare duket se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”.

**34.** Në lidhje me tre prej shitësve të automjetit të blerë nga babai i subjektit, bazuar në shkresën nr. \*\*\*prot., datë 24.4.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezultojnë të jetë regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2009 për veprën penale të parashikuar nga nenet 236/2 dhe 302 të Kodit Penal dhe prokurorë të çështjes kanë qenë dy subjekte të tjera. Ky procedim rezultojnë të jetë regjistruar në një kohë shumë më të hershme se marrëdhënia e babait të subjektit me shitësit e automjetit dhe asnjëri prej tyre nuk është hetuar nga subjekti. Për më tepër, në lidhje me dy nga shtetasit e mësipërm në datën 31.7.2009 është dërguar kërkesa për gjykim.

**35.** Nga hetimi ka rezultuar se subjekti, me kontratën nr. \*\*\*, datë 26.8.2020, ka blerë automjetin tip “Daimler Chrysler” për shumën 3,200 euro. Nga deklarata doganore Import 4 rezultojnë se shitësi e ka blerë këtë automjet për shumën 950 euro dhe se janë paguar detyrimet doganore në shumën 72,449 lekë.

Nga analiza financiare rezultojnë se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

**36.** Nga të dhënat e sistemit TIMS rezultojnë se subjekti gjatë viteve 2006 dhe 2007 ka përdorur tri herë automjetin me targë TR \*\*\* F. Nga të dhënat e AMF-së rezultojnë se për këtë automjet për periudhën 27.4.2008 – 26.4.2009 është prerë policë sigurimi, ku si përdorues rezultojnë subjekti.

**37.** Në lidhje me këtë automjet, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 3.4.2023, ka sqaruar: *“Mjeti me targë TR \*\*\* F është në pronësi të shtetasit B.P.B, i datëlindjes 17.10.1973, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë. Aktualisht punonjës pranë Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në Bashkinë e Tiranës. Me shtetasin B.B njihen që nga fëmijëria. Në lidhje me periudhën 27.4.2008 – 26.4.2009, subjekti sqaroi se në mungesë të një mjeti motorik dhe për nevoja familjare ky mjet i është lënë në përdorim herë pas here nga ana e shtetasit B.B. Në periudhën në fjalë, bashkëshortja e tij ka qenë shtatzënë (prisnin fëmijën e parë) dhe për të qenë i gatshëm në raste urgjente i është lënë në përdorim ky mjet motorik. Në datën 20.6.2008 ka lindur vajza e parë (A. B.) Polica e sigurimit që i përket këtij mjeti motorik është e paguar në datën 27.4.2008, me shtrirje afati vlefshmërie deri më 26.4.2009 dhe fatura e kësaj police është paguar nga vetë pronari i mjetit B.B. Ai dhe me sa i kujtohet edhe vëllai i tij G.B janë regjistruar në këtë policë sigurimi nga vetë pronari, me qëllimin që të njiheshim si përdorues, pasi në këtë periudhë kohore kur është përdorur ky mjet, në bazë të nenit 93 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, kërkohej që të shënohej edhe emri i përdoruesit për efekt kontrolli nga organet ligjzbatuese (policia rrugore). Në atë periudhë, emri i përdoruesit duhej*



*shënuar edhe nëse ishte pjesëtar i së njëjtës familje (bashkëshortit/es, vëllait ose motrës). Ky mjet nuk ka qenë në disponimin e tij gjatë gjithë periudhës së cituar më lart, por vetëm në rastet që ai ka pasur nevojë, pjesën tjetër të kohës, është përdorur nga pronari i saj, B.B”.*

**38.** Subjekti ka bashkëlidhur:

- a. vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga ku rezulton se ndaj shtetasit B.B nuk është regjistruar kallëzim apo procedim penal;
- b. vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2023, të Bashkisë Tiranë (Drejtoria e MZSH-së), nëpërmjet të cilit provohet se z. B.B është punonjës pranë Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në Bashkinë e Tiranës;
- c. vendimin nr. \*, datë 10.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**39.** Në përfundim të hetimit për këtë pasuri në përdorim nga subjekti, nuk ka rezultuar ndonjë dyshim për fshehje. Prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit, subjekti e ka deklaruar përdorimin e tij, si dhe nuk ka rezultuar ndonjë situatë konflikti interesi.

#### **DEKLARIM I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT, ZNJ. A.B – DEKLARIMI I PASURIVE**

**40.** Bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar pasuri në pronësi të saj, por ka deklaruar të ardhura si vijon:

- a. sekretare gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën tetor 2005 – mars 2006, shuma 78,913 lekë;
- b. operatore dhe më pas specialiste shërbimi në Drejtorinë Rajonale Shkodër për periudhën mars 2010 – janar 2015, shuma 1,519,148 lekë;
- c. të ardhura nga raportet e barrë lindjes për periudhën 9.1.2012 – 16.1.2013, shuma 200,398 lekë;
- d. të ardhura nga asistenca e punësimit për periudhën dhjetor 2014 – qershor 2016 (vërtetim nr. \*\*\*), 1 fletë, shuma 94,232 lekë;
- e. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, sekretare, për periudhën shtator 2015 – mars 2016, shuma 306,283 lekë.

**41.** Për të provuar këto të ardhura, subjekti ka depozituar:

- a. vërtetim page nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën tetor 2005 – mars 2006, shuma 78,913 lekë;
- b. vërtetim nr. \*\*\*, datë 21.10.2016, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, për periudhën mars 2010 – janar 2015, shuma 1,519,148 lekë;
- c. vërtetim nr. \*\*\*, datë 31.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, ku vërtetohet se bashkëshortes së subjektit i është paguar raport barrë lindjeje për periudhën 9.1.2012 – 16.1.2013, shuma 200,398 lekë;
- d. vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. \*\*\*, nga ISSH Shkodër, për periudhat dhjetor 2014 – shtator 2015 dhe mars 2016 – qershor 2016, shuma 94,232 lekë;
- e. vërtetim nr. \*\*\*, datë 24.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën 14.9.2015 – 13.3.2016, shuma 306,283 lekë.

Rezulton se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar saktë, sipas të dhënave të dokumentacionit të depozituar.

## KONSTATIME TË TJERA

**42.** Komisioni ka hetuar në lidhje me vendbanimin e subjektit. Në pyetësorin standard, subjekti ka qartësuar vendbanimin e tij. Sipas deklarimeve të subjektit, ai ka jetuar në një banesë me prindërit e tij deri në datën 15.6.2016 dhe, për shkak të amortizimit të saj, është larguar duke jetuar me qira, fillimisht në banesën e shtetasit T.D dhe, më pas, në një banesë 2+1 në pronësi të shtetasit Sh.T. Subjekti deklaron se familja e tij është shtuar edhe me një djalë dhe kjo ka qenë arsyeja që ai ka shkuar të jetojë në një shtëpi më të madhe me qira.

### *Në lidhje me apartamentin e marrë me qira*

**43.** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.1.2017, me deklarues shtetasen T.D dhe subjektin, në të cilën kjo shtetase deklaron se i ka dhënë me qira një pasuri të paluajtshme të llojit apartament me sipërfaqe 74.6 m<sup>2</sup>, ndodhur në Shkodër, kundrejt shumës 15.000 lekë/muaj, për periudhën 15.6.2016 – 30.5.2017.

**43.1** Bashkëlidhur gjendet vërtetimi hipotekor nr. \*\*, datë 7.6.2016, sipas të cilit znj. D ka në pronësi apartamentin me sipërfaqe 74.6 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*.

**43.2** Në DPV-në e vitit 2017, subjekti ka vijuar të deklarojë se jeton me qira, duke sqaruar se ka marrë me qira një apartament, në pamundësi objektive për të vazhduar banimin në shtëpinë e prindërve.

**43.3** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 16.1.2020, sipas së cilës marrëdhënia e qirasë së banesës me znj. D ka vijuar deri në datën 15.1.2020.

**44.** Në lidhje me shtetasen T.D, bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton të jetë regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2023, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal dhe prokuror i çështjes është një subjekt tjetër. Ky procedim rezulton të jetë regjistruar në një kohë shumë më të vonë se marrëdhënia e subjektit me këtë shtetase.

**45.** Subjekti ka depozituar kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 21.1.2020, lidhur midis tij dhe shtetasit Sh.T për dhënien me qira në vlerën 20,000 lekë të një apartamenti 2+1 me sipërfaqe 99.23 m<sup>2</sup>. Këtë apartament z. T e ka përfutur me kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 20.12.2010, për vlerën 4,753,791 lekë.

### *Në lidhje me banesën e prindërve të subjektit*

**46.** Për të provuar pronësinë e babait të tij, subjekti ka depozituar:

- a. vërtetim pronësie datë 10.3.1993, sipas të cilit babai i tij është pronar i një shtëpie banimi me dy kate;
- b. akt dhurimi, datë 13.2.1993, sipas të cilit xhaxhai i subjektit, z. F.B, i ka dhuruar babait të subjektit dhe vëllezërve të tjerë të tij me akt dhurimi një banesë, e cila më pas është pjesëtuar me aktin e pjesëtimit datë 10.3.1993;
- c. vendim nr. \*\*\*, datë 22.12.1994, të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Shkodër, sipas të cilit babait të tij dhe vëllezërve të tij i është shpronësuar një pasuri tokë me sipërfaqe 1,145 m<sup>2</sup> në Shkodër. Komisioni ka vendosur të njohë pronësinë e babait dhe vëllezërve të tij në lidhje me këtë tokë truall;
- d. vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 25.2.2003, sipas të cilit në pronësi të babait të subjektit dhe vëllezërve të tij është në pronësi pasuria nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 1,900 m<sup>2</sup>.

**47.** Nga hetimi i Komisionit, referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2023, të ASHK-së, rezultoi se:

i) Babai i subjektit ka në bashkëpronësi pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, të llojit truall me sipërfaqe 1,900 m<sup>2</sup>, e fituar sipas vendimit të gjykatës nr. \*\*\*, datë 30.10.1995.

Ka pasur në bashkëpronësi pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 420 m<sup>2</sup>, e ardhur me anë të ndarjes së pasurisë. Kjo pasuri është shitur në datën 26.2.2003 me kontratën nr. \*\*\*, për shumën 100,000 lekë.

Dy pasuritë e mësipërme fillimisht kanë qenë një pasuri e vetme me sipërfaqe totale 2,320 m<sup>2</sup> dhe, më pas, me deklaratën nr. \*\*\*, datë 15.2.2003, janë ndarë në dy pasuri. Pasuria me sipërfaqe 2,320 m<sup>2</sup> e ka origjinën nga vendimi nr. \*\*\*, datë 13.2.1995, i Komisionit të Kthimit të Pronave të Bashkisë Shkodër, i cili është prishur me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 30.10.1995, nëpërmjet të cilit trualli i është kthyer babait të subjektit dhe tre bashkëpronarëve të tjerë.

ii) Nga verifikimi në bazën e të dhënave të objekteve në proces legalizimi rezultoi se shtetasi S.B ka aplikim nr. \*\*\*, datë 12.3.2019. Në lidhje me këtë aplikim, nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Shkodër, rezultoi se kemi të bëjmë me një aplikim për kalimin e pronësisë së objektit të ndërtuar para datës 10.8.1991. Ky aplikim ka të bëjë me regjistrimin e banesës së babait të subjektit të rivlerësimit.

**48.** Në lidhje me këto pasuri të babait të subjektit nuk lindin dyshime për fshehje pasurie, si dhe nuk konstatohen problematika sa i përket mënyrës së fitimit të pronësisë.

**49.** Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, informoi se bashkëshortja e subjektit rezultoi e regjistruar si individ privat në DRT Shkodër, në datën 9.4.2020, për përgjegjësinë tatimore Tatim mbi të Ardhurat Individuale.

**49.1** Nga verifikimi i deklaratës individuale vjetore të të ardhurave për vitin 2019 rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura bruto të tjera në shumën 2,233,923 lekë.

**50.** Në lidhje me këto të ardhura, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 3.4.2023, ka sqaruar: *“Në deklaratën në fjalë janë deklaruar të ardhurat neto nga paga dhe shpërblime të bashkëshortes në shumën 870,933 lekë, si dhe shpërblim i bashkëshortes referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 27.7.2015, i Gjykatës Administrative Shkodër, në shumën 1,898,835 lekë”.*

**50.1** Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes:

- Formular i urdhërtransfertes nga shoqëria përmbarimore “G.D.C” sh.p.k., në shumën 1,898,835 në llogarinë e bashkëshortes pranë BKT-së.

Ky fakt konfirmohet edhe nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në BKT, nga ku rezultoi se në datën 21.5.2019 është transferuar shuma 1,898,835 lekë, me emërtimin “G. D.C”, dëmshpërblim për vendimin nr. \*\*\*, datë 27.7.2015, paguar nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve, në datën 19.5.2015.

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2023, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër mbi pagat e bashkëshortes për vitin 2019. Bazuar në këtë vërtetim, bashkëshortja e subjektit ka përfituar shumën 468,088 lekë (paga neto maj – dhjetor 2019).

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.11.2022, i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër mbi pagat e bashkëshortes për vitin 2019. Bazuar në këtë vërtetim,

bashkëshortja e subjektit ka përfituar shumën 402,843 lekë (paga neto janar – prill 2019 në vlerën 288,164 lekë, shpërblim suplementar muaji korrik 66,300 lekë, si dhe shpërblim i taksave muaji shtator 48,379 lekë).

- DPV e vitit 2019.
- Vendim nr. \*\*\*, datë 27.7.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Vendim për pushimin e urdhrit të ekzekutimit, të ekzekutuar tërësisht me nr. \*\* regj., nr. \*\*prot., datë 15.5.2021, të shoqërisë përmbarimore “G.D.C”.
- Formular i urdhërtransfertës nga shoqëria përmbarimore “G.D.C” sh.p.k.. në shumën 828,240 lekë, në llogarinë e bashkëshortes pranë BKT-së.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për ekzekutimin e vendimit të gjykatës nr. \*\*\*/2015.
- Urdhër për vënien e sekuestros në llogarinë e palës debitore nr. \*\*\* regj., nr. \*\* prot., datë 12.6.2018, i shoqërisë përmbarimore “G.D.C” sh.p.k.

**51.** Në përfundim nuk lindin dyshime në lidhje me këto të ardhura.

**52.** Credins Invest, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 5.2.2021, informon se bashkëshortja e subjektit është kliente prej datës së derdhjes së kontributit të parë, 24.4.2018, në fondin e pensionit “C.P”. Nga pasqyra e transaksioneve për periudhën 24.4.2018 – 5.2.2021 rezulton se bashkëshortja e subjektit ka kuota në total 29,7896, në vlerën 41,840 lekë.

**52.1** Në lidhje me këto kuota, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 3.4.2023, ka sqaruar: *“Krijimi i këtyre kuotave ka ardhur si pasojë e kontratës nr. \*\*\* prot., datë 9.8.2018, “Për krijimin e planit profesional në fondin e pensionit vullnetar lidhur midis punëdhënësit: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe C.I sh.a.”. Në bazë të kësaj kontrate dhe urdhrit nr. \*\*\*, datë 13.8.2018, të DPSHTRR-së, pika 3, shkronja “b”, bashkëshortja e tij në cilësinë e kryetares së degës së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Drejtorinë Rajonale Shkodër ka dhënë kontributin përkatës. Kalimi i të ardhurave për krijimin e këtyre kuotave është bërë drejtpërdrejt nga Dega e Financës në përqindjen përkatëse sipas urdhrit të mësipërm, duke i marrë këto të ardhura nga paga mujore e saj”.*

**52.2** Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes:

- kontratën e planit pension profesional vullnetar lidhur mes Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe C.I;
- urdhrin nr. \*\*\*, datë 13.8.2018, të DPSHTRR-së “Për përcaktimin e pozicioneve të punës sipas strukturës dhe masën e kontributeve për personat e punësuar, të cilët përfitojnë nga skema e sigurimit suplementar vullnetar”;
- certifikatën e pronësisë së kuotave, shoqëruar me pasqyrën e transaksioneve për periudhën 2018 – 2022;
- urdhrin e emërimit në detyrë nr. \*\*\*, datë 22.1.2018;
- urdhrin e lirimit nga detyra nr. \*\*\*, datë 15.4.2019.

**53.** Nga dokumentacioni i mësipërm provohen deklaratimet e subjektit në lidhje me pronësinë e kuotave të bashkëshortes së tij në këtë fond pensioni.

**54.** Bashkëshortja e subjektit ka pasur transferta nga SHBA-ja prej shtetases D.H për periudhën 1.11.2017 – 3.1.2018, në total 800 USD.

**54.1** Në lidhje me këtë transferim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 3.4.2023, ka sqaruar: *“D.H është vajza e hallës së bashkëshortes së tij. Këto të ardhura janë dërguar në atë kohë nga halla e bashkëshortes, shtetasja Xh.Ç, për babain e bashkëshortes, të ndjerin A.D, i cili në atë kohë vuante nga një sëmundje e rëndë (tumor në mushkëri). Këto të ardhura janë dërguar me qëllimin për t’i ardhur në ndihmë në mbulimin sadopak të shpenzimeve mjekësore. Për shkak të moshës, halla e bashkëshortes nuk ka pasur mundësi fizike dhe i ka dërguar këto të ardhura nëpërmjet vajzës së saj D.H. Po ashtu edhe prindërit e bashkëshortes në atë periudhë nuk kanë pasur mundësi fizike, prandaj këto të ardhura janë dërguar në emër të bashkëshortes me W.U, e cila, pasi i ka tërhequr, ua ka dhënë prindërve të saj. Halla e bashkëshortes është nënshtetase amerikane dhe trajtohet me pension në këtë shtet. Babai i bashkëshortes ka ndërruar jetë në datën 29.5.2018 si pasojë e sëmundjes që kishte”.*

**54.2** Subjekti ka depozituar:

- lëvizjet e llogarisë së shtetases Xh.Ç/D.H;
- certifikatën e martesës së shtetases D.H, nga ku rezulton se mbiemri i vajzërisë së saj ka qenë Ç dhe mëmësia është Xh;
- certifikatën familjare të hallës së bashkëshortes;
- certifikatën e trungut të familjes së bashkëshortes, nga ku rezulton se shtetasit Xh.D dhe A.D janë motër e vëlla;
- dokumentacionin mjekësor të babait të bashkëshortes, shtetasit A.D;
- certifikatën e vdekjes së shtetasit A.D, i cili rezulton të ketë ndërruar jetë më 29.5.2018.

**55.** Nuk rezulton ndonjë dyshim në lidhje me këtë të ardhur.

**56.** Në përfundim të hetimit, Komisioni ka kryer analizën financiare prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, nga ku rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet gjatë gjithë viteve.

### **Konkluzion për vlerësimin e pasurisë**

**57.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht e plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**58.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**59.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**60.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

**61.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>12</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**62.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**63.** Komisioni kreu një hetim<sup>13</sup> të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati.

**64.** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se ndaj vëllait të subjektit, z. G.S.B, i cili që nga viti 2011 ushtron detyrën e përmbaruesit gjyqësor privat, janë regjistruar procedimet<sup>14</sup> penale si vijon:

a. Procedimi penal nr. \*\*\*/2009, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal (korrupsion pasiv), pushuar me vendimin datë 13.7.2009, në mbështetje të nenit 328/1, shkronjat “b” dhe “dh” të Kodit të Procedurës Penale.

Përfshirja e nenit 259 të Kodit Penal në grupin e veprave penale të krimit të organizuar është bërë me ndryshimet ligjore me ligjin nr. 70, datë 27.4.2017. Në këtë moment subjekti e kishte plotësuar deklaratën e kontrollit të figurës, për rrjedhojë nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mosdeklarimin e këtij procedimi në këtë deklaratë.

b. Procedimi penal nr. \*\*\*/2013, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pushuar me vendimin datë 28.3.2013. Në lidhje me këtë procedim, hetimi është bërë për shtetasin L.K, me detyrë drejtor i EKB-së Shkodër, ndërkohë për vëllain e subjektit është konstatuar se ai ka kryer një gabim material në përpilimin e akteve të përmbaruesit, të cilat nuk kanë sjellë ndonjë pasojë juridike apo cenim të interesit të ndonjë personi.

c. Procedimi penal nr. \*\*\*/2016, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pushuar me vendimin datë 22.12.2016. Në këtë rast vëllai i subjektit ka qenë në cilësinë e kallëzuesit.

---

<sup>12</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, të KDZH-së.

<sup>13</sup> Shihni dosjen me informacion të klasifikuar, të përditësuar, të subjektit të rivlerësimit.

<sup>14</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- d. Procedimi penal nr. \*\*\*/2021, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në datën 1.3.2022 prokurori i çështjes ka dërguar kërkesën për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.4.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 1.6.2022.
- e. Procedimi penal nr. \*\*\*/2022, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili është në fazën e hetimeve.

Në asnjë prej procedimeve të mësipërme subjekti nuk rezulton të jetë prokuror i çështjes.

**65.** Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, arrin një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

#### **Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**66.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Agron Bushati, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**67.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

#### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë**

**68.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**69.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

**70.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësia personale dhe angazhimi profesional.

**71.** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe analizimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika.

### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së**

**72.** Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton se ndaj subjektit të jenë dhënë këto masa disiplinore:

**72.1** Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 30.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, për shkeljet e kryera ka marrë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra e prokurorit”.

**72.2** Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 8.2.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, është dhënë masa disiplinore “Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 1 (një) viti”.

**73.** Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme u gjetën vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm, që i përkasin punës së subjektit për vitet 2013 e 2014, vlerësuar “Mirë” dhe për vitet 2015 e 2016 “Shumë mirë”.

**74.** Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, për kallëzime dhe të dhëna të tjera në lidhje me subjektin, rezulton se ndaj tij kishte paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër shtetasi P.T.M, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kallëzimi penal është përcjellë për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese ishte vendosur “Mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin penal nr. \*\*\*/2018, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale”.

**75.** Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se ndaj subjektit janë paraqitur tri ankesa:

**75.1** Ankesat nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* të vitit 2006, të shtetasve A dhe A.M – në ankesën e tyre këta shtetas, të cilët kanë qenë të arrestuar për llogari të një procedimi penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, që e ndiqte subjekti, ata kanë pretenduar se ai ka falsifikuar aktet e procedimit penal. Kjo ankesë rezulton të jetë përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2006. Në kuadër të kësaj ankese subjekti ka paraqitur pranë Drejtuesit të Prokurorisë kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i procedimit penal nr. \*\*\*/2004, në ngarkim të të pandehurve A.M, A.M dhe të tjerë. Mbi bazën e kësaj kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Shkodër ka marrë vendim për zëvendësimin e prokurorit Agron Bushati në gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*/2004.

**75.2** Ankesa nr. \*\*\* e vitit 2015, e shtetasit K.B – në ankesën e tij ky shtetas ka pretendime për humbje/fshehje të fashikullit të hetimeve nga subjekti. Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 14.7.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, ankuesit i është kthyer përgjigje duke i bërë me dije gjithë fazën e hetimit dhe gjykimin që ka ndjekur procedimi penal për të cilin ankuesi kishte paraqitur këtë ankesë. Në lidhje me këtë ankesë, Komisioni ka kryer një hetim të plotë dhe është trajtuar në sektorin “Denoncime”, pasi e njëjta ankesë është paraqitur edhe në Komision.

**75.3** Ankesa nr. \*\*\* e vitit 2018, e shtetasit Z.H– në ankesën e tij ky shtetas ka pretendime për vendimmarrje të subjektit. Në lidhje me këtë ankesë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, i është kthyer përgjigje ankuesit duke i bërë me dije se Prokurori i Përgjithshëm nuk ka më kompetencë për kontrollin e veprimtarisë së prokurorive dhe se çdo pretendim që lidhet me vendimmarrjet e prokurorëve mund të paraqitet



brenda afateve ligjore në gjykatën kompetente. Për këtë shkak kjo ankesë rezulton të jetë arkivuar.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me kallëzimet apo masat e mundshme disiplinore ndaj subjektit**

**76.** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se subjekti me urdhrin nr. \*\*, datë 30.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka marrë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra e prokurorit”.

**76.1** Në lidhje me këtë masa disiplinore, ajo nuk i përket periudhës së rivlerësimit, për rrjedhojë nuk është analizuar.

**77.** Me urdhrin nr. \*\*, datë 8.2.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, është marrë masë disiplinore “Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë 1 vit”.

**77.1** Masa disiplinore e mësipërme është dhënë pasi nga një kontroll i Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër është konstatuar se pas kontrollit të ushtruar në datën 26.9.2007 rezulton se subjekti ka mbajtur në kasafortë pa dorëzuar procedimet penale nr. \*\*\*/2000, nr. \*\*\*/2003 dhe nr. \*\*\*/2005. Gjithashtu, subjekti deri në datën 11.10.2007 nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një dosje të marrë në maj të vitit 2006.

**78.** Për sa më sipër, duket se subjekti ka zvarritur procedimet penale për periudha të gjata kohore. Subjektit iu kërkuan shpjegime bindëse në lidhje me këtë konstatim.

**79.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, ai ka shpjeguar: *“Periudha kohore 2005 – 2007 përkon me një periudhë të vështirë të jetës sime, e cila ka afektuar drejtpërdrejt dhe në ushtrimin normal të profesionit ka afektuar jetën time në çdo aspekt. Kjo pasi, në këtë periudhë jam përballur me probleme të rënda shëndetësore të prindërve të mi.*

*Në këtë situatë më është dashur që të jem de facto “kryefamiljar”, “kujdestar” dhe “psikolog” i prindërve të mi, duke i asistuar çdo ditë (në mënyrë permanente), në mënyrë që të çoja drejt normalitetit situatën emocionale të krijuar në shtëpi dhe ndërkohë ngarkesa në punë vijonte me ritmin normal. Sot besoj që i vetmi faj i imi në atë kohë ka qenë që nuk kam kërkuar periudhë lejeje të përkohshme nga puna dhe jam munduar t’i përballoj të gjitha këto ngarkesa njëherësh i vetëm.*

*Një situatë të tillë e kam bërë të ditur në ambientin e punës vetëm në momentin që jam paraqitur para Komisionit Disiplinor në atë kohë dhe kjo rrethanë u mirëkuptua nga Komisioni dhe u reflektua në masën disiplinore që m’u dha...”.*

**80.** Subjekti ka sqaruar në vijim për çështjet konkrete:

*“ - Procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2000*

*Procedimi penal nr. \*\*\* është regjistruar në datën 21.4.2000 dhe bën fjalë për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, pa autor të identifikuar.*

*Me vendimin e datës 9.5.2000, prokurori L. D. (njëkohësisht edhe Drejtues i Prokurorisë) ka vendosur pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2000, për moszbulim autori.*

*Kjo çështje është rifilluar në datën 30.10.2002 dhe është pezulluar sërish me vendimin e datës 19.6.2002.*

*Në datën 27.12.2005, nga ana e policisë gjyqësore, procedimi në fjalë është sjellë me relacion për parashkrim të ndjekjes penale, e cila më ka kaluar mua për veprim si prokuror i çështjes. I vetmi veprim formal që duhej kryer nga ana ime ka qenë rifillimi i hetimeve dhe pushimi për efekt parashkrimi. Moskryerja e këtyre veprimeve në thelb nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike, pasi de facto ndjekja penale ishte tashmë parashkruar.*

*- Procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2005*

*Procedimi penal nr. \*\*\* është regjistruar në datën 16.4.2005 dhe bën fjalë për veprat penale “Plagosje e rëndë me dashje” dhe “Mbajtja pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 88/1 dhe 278/2 të Kodit Penal.*

*Me vendimin e datës 10.10.2006 është vendosur pezullimi i hetimeve për moszbulim të autorit...*

*- Procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2003*

*Procedimi penal nr. \*\* i vitit 2003, për të cilin parimisht kam marrë edhe masën disiplinore, është regjistruar në datën 13.6.2003, për veprat penale “Vrasje me dashje” dhe “Mbajtja pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 278/2 të Kodit Penal.*

*Me vendimin e datës 10.2.2004 është vendosur pezullimi i hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2003, për moszbulim të autorit.*

*Dosja më është dhënë sërish dorazi për studim nga Drejtuesi i Prokurorisë...*

*Lidhur me këtë dosje, unë nuk kam marrë vendim rifillimi, pasi kam pasur dyshimet e mia nëse ekzistonin realisht kushtet për rifillimin e hetimeve. Kjo pasi relacioni për rifillim i policisë i referohej vetëm burimeve policore, sipas të cilave babai dhe xhaxhai i të dyshuarit në atë kohë deklarorin se ishin në gjakmarrje/të ngujuar për shkak se familjari i tyre ishte autori i vrasjes. Pra, kishim të bënim me pohime të familjarëve të autorit të prezumuar si i dyshuar, të dhëna verbalisht dhe jo në formën e duhur ligjore para autoriteteve ligjzbatuese. Një informacion i tillë është marrë me rezervë nga ana ime, nuk më është dukur i besueshëm pasi nuk ishte e logjikshme që vetë familjarët (babai dhe xhaxhai i të dyshuarit) ta inkriminonin familjarin e tyre dhe në optikën time ishte një tentativë për të fituar azil jashtë Shqipërisë, nuk ofronte garanci që këto pohime së pari ishin të vërteta dhe së dyti që këto pohime do të jepeshin nga shtetasit në fjalë në momentin që do të thirreshin për t'u pyetur nga Prokuroria apo nuk do të ndryshoheshin më vonë gjatë gjykimit. Përgjegjësia ime qëndron vetëm në faktin se, sado e palogjikshme që ishte situata, duhej ta kisha tentuar rifillimin dhe marrjen në pyetje të këtyre shtetasve, duke zbatuar dispozitat e nenit 158 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, pavarësisht bindjes sime nëse një veprim i tillë do të sillte apo jo rezultat pozitiv”.*

**81.** Si përfundim, në mënyrë të përmbledhur lidhur me tre rastet e cituara më lart, subjekti ka sqaruar se procedimet nr. \*\*\*/2000 dhe nr. \*\*\*/2005 janë procedime për të cilat ai ka vënë në dijeni Drejtuesin e Prokurorisë në momentin që i është kërkuar informacion lidhur me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2003. Nuk ka qenë konstatim i askujt, por ka qenë ai vetë i cili ka vënë në dijeni lidhur me faktin se përveç procedimit në fjalë kishte edhe dy procedime të tjera, të cilat duheshin rifilluar.

**81.1** Pikërisht këto rrethana u paraqitën “ndryshe” nga grupi i inspektimit në atë periudhë, sikur subjekti i kishte mbajtur qëllimisht në kasafortë tri procedimet në fjalë. Në fakt për dy nga këto procedime është marrë dijeni nëpërmjet vetë subjektit. Gjithsesi, këto rrethana janë sqaruar

gjatë shqyrtimit në Këshillin e Prokurorisë dhe është konkluduar se asgjë nuk ka qenë e qëllimshme apo me dashje nga ana e tij apo për përfitime të asnjë lloj natyre.

**82.** Lidhur me procedimin e muajit maj të vitit 2006, subjekti ka pretenduar se nuk arrin të japë ndonjë shpjegim, pasi të vetmet procedime që janë marrë në shqyrtim nga Këshilli i Prokurorisë në atë kohë janë tri procedimet e lartpërmendura. Me sa kujton ai, vijon subjekti, në atë periudhë është aluduar që ishte edhe një procedim penal i vitit 2006, por më pas rezultoi që nuk ishte procedim i regjistruar apo hetuar prej tij.

**83.** Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2007, të Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë shkresë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër porositet si vijon:

- *Procedimi penal nr. \*\*\*/2000, i pezulluar në datën 19.6.2002, të rifillojnë hetimet dhe të merret vendimi i pushimit në bazë të nenit 66 të Kodit Penal.*
- *Procedimi penal nr. \*\*\*, i pezulluar në datën 10.2.2004, të rifillojnë hetimet dhe të kryhen veprimet hetimore të domosdoshme.*
- *Procedimi penal nr. \*\*\*, pezulluar në datën 10.10.2006, të rifillohen hetimet dhe të kryhen veprimet hetimore të domosdoshme.*

**84.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se, pavarësisht se duken bindëse, ato janë në nivel deklarativ dhe të pashoqëruar me prova për të mbështetur pretendimet e tij. Për rrjedhojë, nga ana e subjektit rezulton se janë shfaqur mangësi në kriterin e aftësive organizative. Në lidhje me këto mangësi rezulton se ndaj subjektit është marrë një masë disiplinore dhe pas përfundimit të kësaj mase ai nuk ka vijuar më tej me kryerjen e të njëjtave veprimeve si në rastin e procedimeve të mësipërme. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se ato janë korrigjuar nga subjekti përgjatë 14 viteve pune në vijim të tij, pasi nga 5 dosjet e përzgjedhura me short dhe nga 3 vendimet e depozituara prej tij nuk janë konstatuar zvarritje të procedimeve penale.

**84.1** Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka marrë një dënim në lidhje me këto procedime, si dhe nuk ka vijuar më tej me zvarritjen e procedimeve, vlerëson se nuk jemi përpara plotësimit të kriterëve për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, si dhe për t'u konsideruar si shkak për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra.

**85.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, informon se ndaj subjektit janë regjistruar tri kallëzime penale dhe dy procedime penale, si vijon:

1. Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2018
2. Kallëzim penal nr. \*\*\*/2018

Në lidhje me këto dy kallëzime rezulton se objekt i hetimit të organit të prokurorisë kanë qenë veprimet e dy subjekteve të tjerë rivlerësimi. Ndërkohë, në lidhje me subjektin nuk janë kryer veprime hetimore. Nga verifikimi i fashikujve penalë konstatohet se hetimet në lidhje me procedimin penal për të cilin ishte bërë kallëzimi penal nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, por nga një subjekt tjetër.

3. Kallëzimi penal nr. \*\*\*/2020

Nga verifikimi i fashikullit penal konstatohet se ky kallëzim nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, por me një subjekt tjetër.

#### 4. Procedimi penal nr. \*\*/2009

Nga verifikimi i fashikullit penal konstatohet se procedimi penal nuk është regjistruar në emër të subjektit, por është pa autor, pasi nga ana e Prokurorisë nuk është evidentuar prokurori që ka pasur dosjen e një procedimi i cili rezultonte i humbur. Ky procedim është pushuar, pasi është parashkruar ndjekja penale.

#### 5. Procedimi penal nr. \*\*\*/2019

Nga verifikimi i fashikullit penal konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë fillimisht ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e bërë ndaj subjektit të rivlerësimit. Në këtë kallëzim pretendohet se subjekti kishte shpërdoruar detyrën pasi kishte urdhëruar ekzekutimin e një vendimi penal, i cili sipas kallëzuesit duhej të aplikohej ligji nr. 141/2016, "Për dhënie amnistie". Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vendim nr. \*\*, datë 27.2.2019, është vendosur pranimi i ankimit të kallëzuesit, duke u shfuqizuar vendimi për mosfillimin e procedimit dhe duke u detyruar Prokuroria për vazhdimin e hetimeve.

Në vendim Gjykata ka parashtruar se nga ana e Prokurorisë duhet të kryheshin veprimet e mëposhtme hetimore:

1. Të administrohej vendimi nr. \*\*\*, datë 12.4.2018, i Gjykatës së Apelit Shkodër, ku të verifikohet arsyeja pse është vendosur mospranimi i ankimit; të hetohet në lidhje me faktin nëse shtetasi P.M është njoftuar apo jo në lidhje me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga subjekti; të pyetet shtetasi P.M dhe t'i merren provat që ka dashur të dorëzojë që në momentin që ka paraqitur kallëzimin penal.
2. Të administrohet vendimi nr. \*\*\*, datë 12.9.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasit P.M dhe shuarjen e masës së dënimit të dhënë me vendimin penal nr. \*\*\*, datë 16.6.2018.

Prokuroria, pasi ka regjistruar procedimin penal, ka paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes në datën 7.7.2020.

Nga analizimi i fashikullit penal konstatohet se subjekti ka dërguar për ekzekutim vendimin penal nr. \*\*\*, datë 16.6.2016, për të cilin Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.4.2018, kishte vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur.

Në datën 12.9.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur shuarjen e masës së dënimit të dhënë sipas vendimit penal nr. \*\*\*, për shkak të aplikimit të ligjit nr. 141/2016, "Për dhënie amnistie".

Në këtë vendim, Gjykata shprehet se vendimi nr. \*\*\* konsiderohet se për shkak të ligjit ka marrë formë të prerë 10 ditë pasi është shpallur konform nenit 420/1 të Kodit të Procedurës Penale. Ky arsyetim i Gjykatës mbështetet në faktin se Gjykata e Apelit kishte vendosur mospranimin e ankimit të të pandehurit, për rrjedhojë, bazuar në nenin 420, pika 4, parashikohet: *"Kur gjykata vendos mospranimin e ankimit, vendimi konsiderohet i paankimuar për efekt të vënies në ekzekutim. Vendimi konsiderohet i paankimuar për efekt të vënies në ekzekutim"*.

**86.** Komisioni, pavarësisht përfundimit të procedimit penal, sipas të cilit subjekti nuk ka kryer vepër penale, konstaton se:

- i) Nga ana e subjektit nuk janë zbatuar parashikimet e nenit 420/4 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me përlllogaritjen e kohës së hyrjes në fuqi të vendimit nr. \*\*\*.
- ii) Subjekti nuk ka zbatuar parashikimet e nenit 463<sup>15</sup>, pasi në dosje gjendet vetëm njoftimi i bërë ndaj shtetasit P.M dhe jo mbrojtësit të tij.
- iii) Subjekti, bazuar në nenin 3/1 të ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”, si dhe në zbatim të nenit 465/1<sup>16</sup> të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka marrë për bazë faktin se shtetasi P.M ishte i amnistuar, për sa kohë ishte dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim më të ulët se 3 vjet, vendim i cili për efekt të ekzekutimit kishte marrë formë të prerë 10 ditë pasi ishte shpallur nga gjykata më 16.6.2016, pra përpara datës 25.12.2016, të përcaktuar në ligjin nr. 141/2016.

**87.** Subjektit iu kërkuan shpjegime bindëse në lidhje me këto konstatime. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, ai ka sqaruar: *“Fillimisht dua të theksoj se unë si prokuror i Zyrës së Ekzekutimeve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër kam pasur bindjen e brendshme se i dënuari P.M nuk përfitonte as nga zbatimi i nenit 420/4 të Kodit të Procedurës Penale dhe as nga zbatimi i ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”. Këtë bindje timen e kam reflektuar si në vendimmarrjen për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, ashtu edhe në qëndrimin refuzues që kam mbajtur gjatë gjykimit me objekt “Shuarjen e dënimit për efekt amnistie”, caktuar ndaj shtetasit në fjalë me vendimin nr. \*\*\*/16.6.2006, për të cilin Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*/12.4.2008, ka vendosur “Mospranimin e ankimit”. Këtë bindje e kam krijuar duke iu referuar rrethanave të ligjit dhe të faktit, pikërisht neni 420/4 i Kodit të Procedurës Penale është shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 97 dhe hyrë në fuqi më 1.8.2017.*

*Kjo dispozitë nuk ka qenë në fuqi në kohën kur, sipas vetë përmbajtjes së dispozitës, interpretimit literal të saj, supozohet të ketë marrë formë të prerë vendimi nr. \*\*\*/16.6.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

*Po të mbahet parasysh përmbajtja e dispozitës, kjo edhe në kontekstin e vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit që ka vendosur “Mospranimin e ankimit”, i bie që vendimi të ketë marrë formë të prerë pas 10 ditësh nga e nesërmja e marrjes dijeni nga i dënuari për vendimin e arsyetuar ose 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, pasi në atë kohë nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të bëra me ligjin nr. 35/2017 lidhur me afatin kur fillon të ecë e drejta e ankimit.*

*Po të mbahet parasysh legjislacioni procedural penal i kohës kur është dhënë vendimi në Gjykatën e Shkallës së Parë, i bie që vendimi ka marrë formë të prerë në Gjykatën e Apelit, pra jo pas 10 ditësh.*

---

<sup>15</sup> Vendimet e prokurorit i njoftohen brenda 30 ditëve mbrojtësit të caktuar nga i interesuari ose, kur nuk ka të tillë, atij të caktuar nga prokurori.

<sup>16</sup> Në caktimin e kohës së dënimit me burgim, prokurori llogarit periudhën e paraburgimit të vuajtur për të njëjtën vepër ose për një vepër penale tjetër, periudhën e dënimit me burgim të shlyer për një vepër penale tjetër, kur dënimi përkatës është revokuar ose kur për veprën penale është dhënë amnisti apo falje.

*Qartazi, në atë periudhë është krijuar një kontradiktë në përcaktimin e faktit juridik se kur ka marrë formë të prerë vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ka pasur debate juridike mes kolegësh për raste të ngjashme.*

*Kontradiktë mes interpretimit literal të nenit 420/4 të Kodit të Procedurës Penale (sipas të cilit vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë merr formë të prerë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit) dhe interpretimit logjik, sintetik, historik dhe krahasimor, sipas të cilit, nisur nga fakti se ligji nr. 35/2017, që shtoi paragrafin e 4-t në nenin 420 të Kodit të Procedurës Penale, bën pjesë në të drejtën procedurale.*

*Në këtë optikë, ndryshe nga e drejta penale/materiale, e cila sanksionon zbatimin e ligjit penal/material favorizues, e drejta penale procedurale e zbatueshme është ajo e kohës së kryerjes veprimi/aktit/vendimit procedural.*

*Duke qenë se ligji 35/2017, nuk ka qenë në fuqi në kohën kur është dhënë vendimi nr. \*\*\*datë 16.6.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, arrihet në përfundimin se e drejta procedurale e zbatueshme për të përcaktuar momentin kur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ka marrë formë të prerë është pikërisht momenti/koha kur kjo gjykatë ka dhënë vendimin. E, si rrjedhim, sipas këtij interpretimi ky vendim nuk ka marrë formë të prerë pas 10 ditësh, por në një kohë më të largët, pikërisht në datën 12.4.2018 (me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.4.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër), datë kjo e cila nuk përputhet me kohën kur ka hyrë në fuqi neni 3 i ligjit nr. 141/2016, "Për dhënie amnistie", pikërisht në datën 14.1.2017.*

*Në kushtet kur ka dy interpretime të normës dhe të dyja këto interpretime janë zbatuar nga praktika gjyqësore në raste të ngjashme, unë personalisht kam qenë i bindur se duhej zbatuar interpretimi i dytë, sipas të cilit vendimi i dhënë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017 nuk merr formë të prerë në kohën që përcakton neni 420/4 i Kodit të Procedurës Penale, pasi ky paragraf (që përcakton norma procedurale, jo norma materiale) nuk mund të ketë fuqi prapavepruese, pasi e drejta procedurale nuk ka asnjëherë fuqi prapavepruese.*

*Unë kështu e kam kuptuar dhe interpretuar ligjin në atë kohë dhe vlerësoj se referuar nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 ka qenë e drejta ime si prokuror ta interpretoj ligjin në mënyrë të pavarur, sipas bindjes sime të brendshme, pa u ndikuar nga asnjë rrethanë apo arsye.*

*Sa më lart, është theksuar edhe nga KPA-ja në vendimin nr. \*\*/2020, për subjektin F. V., me të cilin Kolegji ka përcaktuar standardin që zbatohet në rastin kur magjistrati interpreton ligjin sipas bindjes së tij të brendshme dhe nenit 3 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit nuk mund të kritikohet vlerësimi i magjistratit përveçse në rrugën e zakonshme të ankimit. Në të kundërt cenohet pavarësia e pushtetit gjyqësor.*

*Vetëm kur ka rrethana/elemente që tregojnë keqbesimin e magjistratit në kryerjen e detyrës, kur këto rrethana provohen, atëherë mund të lindë përgjegjësia e magjistratit. Këto rrethana mungojnë tërësisht në rastin konkret, për të cilin më është vënë barra e provës nga Komisioni. Përkundrazi, ka dy rrethana që provojnë qartazi mirëbesimin dhe ndershmërinë time në trajtimin e rastit:*

*Së pari, në kohën e nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit, datë 13.5.2018, unë kam qenë i ndërgjegjshëm se ka praktika gjyqësore të ndryshme dhe të paunifikuara në trajtimin e rasteve të së njëjtës natyrë me rastin objekt analize. Nga ana ime është interpretuar ligji siç e kam relatuar më lart, referuar bindjes sime të brendshme dhe të pavarur.*

*Si provë të praktikave të ndryshme gjyqësore, të paunifikuara, ju paraqes vendimin nr. \*\*, datë 1.3.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër...*

*Së dyti, me një interpretim paralel me atë të mësipërm, që shpie në të njëjtin përfundim, mund të arsyetohet si vijon:*

*Vendimet e GJEDNJ-së janë të zbatueshme për rendin tonë të brendshëm, pasi përfaqësojnë interpretimin autoteknik të neneve të KEDNJ-së<sup>17</sup>.*

*Duke qenë se ligji nr. 35/2017, duke shtuar paragrafin 4 të nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale, e cila është qartësisht normë procedurale me pasoja materiale, atëherë lind pyetja: “Kush është ligji penal më favorizues për vuajtjen e dënimit, neni 420 i Kodit të Procedurës Penale që ka qenë në fuqi në kohën kur është dhënë vendimi nga Gjykata e Shkallës së Parë, pra para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, apo pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe, për rrjedhojë, edhe para hyrjes në fuqi të paragrafit të 4-t të nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale?”*

*Në vlerësimin tim, përgjigjja është e qartë se është përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017. Atëherë, duke qenë se ligji penal favorizues është përpara, kjo sjell dy pasoja, njëren pozitive, por, në raport me një ligj tjetër, sjell edhe një pasojë negative. Të dyja këto pasoja lidhen me faktin se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, pikërisht sipas zbatimit të ligjit penal favorizues, konsiderohet se merr formë të prerë pas përfundimit në Gjykatën e Apelit.*

*Pasojat janë:*

- 1. Pasoja pozitive është se koha deri sa çështja të gjykohet në apel llogaritet me vuajtjen e dënimit nëse i pandehuri do të ishte me masë sigurimi “Arrest në burg” apo “Arrest në shtëpi”.*
- 2. Pasoja negative është se nuk përfiton nga ligji i amnistisë, pasi nga interpretimi i mësipërm, vendimi merr formë të prerë jo sipas nenit 420/2, por në kohën që do të merrte formë të prerë përpara se të hynte në fuqi kjo normë.*

*Sa më sipër arsyetova duke iu referuar rrethanave të ligjit. Por kam vlerësuar dhe vlerësoj se ka edhe një rrethanë fakti, sipas së cilës shtetasi P.M nuk përfitonte nga ligji nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”.*

*Më konkretisht, siç edhe pranohet nga vendimi i Gjykatës së Apelit, ankuesi ka bërë një ankim pa shkak ligjor, pra një ankim “kot, sa për sy e faqe”. Nga kjo lehtësisht arrihet në përfundimin se shtetasi në fjalë nuk ka synuar mbrojtjen e një të drejte përmes ankimit, por vetëm ka pasur si synim të shmangë dhe të shtyjë në kohë hyrjen në fuqi të vendimit të dënimit dhe, për rrjedhojë, ekzekutimin e këtij dënimi.*

*Ky qëllim për shmangien e zbatimit të vendimit gjyqësor është e njëjta gjë si shmangia e zbatimit të ligjit penal dhe, në analizë të fundit, është e njëjtë me sjelljen e personave që i fshihen drejtësisë, me ndryshimin e vetëm që në këtë rast ndaj këtij shtetasi nuk ka pasur një masë sigurimi dhe ka qenë në kushte më të favorshme që të shfrytëzojë të gjitha normat ligjore me qëllim përfitimin personal...*

---

<sup>17</sup> Vendimi *Scopola vs Italia* i GJEDNJ-së lidhur me nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së, ku është vendosur standardi që normat e legjislacionit procedural që sjellin ndikim material në caktimin e dënimit penal i nënshtrohen parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues, njësoj si ligji material penal.

*Lidhur me problematikën e ngritur për mosnjohimin e mbrojtësit, sqarohet se shtetasi në fjalë, siç citohet edhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 16.6.2016, është mbrojtur personalisht, nuk ka pasur mbrojtës ligjor as gjatë hetimit dhe as gjatë gjykimit. Në këto kushte, unë nuk kam pasur dijeni se shtetasi në fjalë, më vonë, gjatë gjykimit në Apel, është asistuar nga një mbrojtës. Theksoj se vendimi që vjen për ekzekutim në momentin që merr formën e prerë, si për rastin konkret, ashtu edhe për çdo rast tjetër, nuk është vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Apelit, por është vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë me shënimin në fund lidhur me mënyrën e disponimit të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, në atë moment kur mua më duhej që brenda afatit ligjor të nxirrja urdhrin e ekzekutimit, nuk kam pasur asnjë mundësi objektive të marr dijeni nëse ky shtetas është asistuar apo jo nga një mbrojtës gjatë gjykimit në apel. Për këtë arsye është njoftuar vetëm personi i interesuar”.*

**88.** Subjekti ka bashkëlidhur vendimin nr. \*\*, datë 1.3.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Në faqen 12 të këtij vendimi Gjykata shprehet: “...ndërsa në rastet kur situata paraqitet më komplekse dhe ka vend për interpretim ligjor, sigurisht që përfitimi nga ligji për amnistinë do të bëhej nga ana e gjykatës. Ashtu si edhe ka rezultuar nga aktet, në rastin konkret nuk jemi para një rasti të pastër të përfitimit nga amnistia, pasi, së pari, kërkesa është bërë në vitin 2018 kur ligji i përket vitit 2016 dhe ajo që është më e rëndësishme, ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë në vitin 2018 pas vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit për mospranimin e ankimit. Për sa kohë prokurori ishte njohur vetëm me dispozitivin e vendimit dhe jo me arsyetimin e tij, ai nuk mund të arrijë në konkluzion për shuarjen e dënimit, interpretim, të cilin mund ta realizonte vetëm gjykata...”.

**89.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, konstaton se zgjidhja e dhënë nga subjekti i përket themelit, për rrjedhojë nuk mund të jetë objekt i vlerësimit profesional. Për më tepër, Gjykata e Apelit ka konstatuar se nuk ka qenë tagri i subjektit për të arritur në konkluzionin për shuarjen e masës së dënimit, por ai i përkiste interpretimit të Gjykatës.

## **Denoncime**

**90.** Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 4 denoncime të paraqitura pranë Komisionit:

### **90.1 Denoncim i shtetasit K.B<sup>18</sup>**

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka zhdukur një denoncim të tij. Pas zhdukjes së denoncimit ai është ankuar për subjektin e rivlerësimit, si dhe për të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët që kanë shqyrtuar ankimet e tij, duke mbrojtur subjektin.

Duke qenë se në ankim nuk kishte asnjë shtjellim në lidhje me pretendimet e ankuesit, Komisioni ka kryer një hetim të plotë, si vijon:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2023, ka vënë në dispozicion kopje të kallëzimit penal nr. \*\*\* të vitit 2010.

Nga analizimi i fashikullit penal të procedimit rezulton se:

- i) Në datën 12.11.2010, Prokuroria e Rrethit Lezhë ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal nr. \*\*\*.

---

<sup>18</sup> Nr. \*\*\*, datë 5.10.2018.



Në vendimin e mosfillimit citohet se shtetasi K.B ka paraqitur edhe një kallëzim tjetër për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtëve persona, për të cilin është dhënë zgjidhje duke u vendosur mosfillimi. Më tej trajtohet kallëzimi i z. B, i cili pretendon se në vitin 2002 ka kryer një kallëzim, pasi është kanosur seriozisht për jetën nga shtetasi A.P. Ky kallëzim është administruar nga subjekti dhe është humbur prej tij.

Prokurori, në lidhje me këtë kallëzim, ka argumentuar se veprat penale janë shuar pasi kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale dhe, për pasojë, ndjekja penale ndaj tyre nuk mund të vazhdojë.

ii) Në datën 23.12.2008 është vendosur mosfillimi i kallëzimit nr. \*\*\*, datë 3.12.2008, i shtetasit K.B nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në vendimin e mosfillimit citohet se shtetasi K.B ka depozituar një kallëzim ndaj prokurorit Agron Bushati lidhur me një kallëzim penal të bërë në datën 13.8.2002. Nga studimi i këtyre materialeve rezulton e provuar se shtetasi K.B ka bërë një kallëzim në gusht të vitit 2002 ndaj inspektorit të bashkisë A.P, për veprën penale “Kanosje”. Ky kallëzim është përcjellë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2002 dhe është marrë kundrejt nënshkrimit nga prokurori i kësaj Prokurorie Agron Bushati për verifikim. Nga verifikimet e kryera është vërtetuar se prokurori Agron Bushati e ka marrë këtë kallëzim dhe nuk e ka regjistruar në Prokurori, por që nga koha e marrjes së kallëzimit e deri në bërjen e tij kanë kaluar më shumë se 5 vjet, duke u vendosur në kushtet ligjore të parashikuara nga neni 66/c i Kodit të Procedurës Penale, pra vepra penale është parashkruar.

Ky vendim është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendim nr.\*\*, datë 01.07.2009 për shkak të moskompetencës e dërgimin e çështjes në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

iii) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*/2009. Në datën 11.1.2010, kjo Prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. \*\*, datë 17.10.2012.

Në dosjen e raportit profesional të depozituar nga KLP-ja gjendet shkresa nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2015, e Prokurorisë së Rrethit Lezhë, sipas së cilës në bazë të vendimit nr. \*\*, datë 17.10.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2012 për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në vijimësi ka kryer hetime për llogari të procedimit, duke vendosur pushimin e hetimeve në datën 8.3.2013.

Nga ana e Komisionit, bazuar në dosjen e ankesës, nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

## **90.2 Denoncim i shtetasve P.N dhe M.P<sup>19</sup>**

Denoncuesi ankohet për disa subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin Agron Bushati. Në denoncim ai deklaroi se subjekti në cilësinë e prokurorit të gatshëm ka ndihmuar drejtuesit e Komisarariatit Shkodër për të liruar vrasësit e fëmijëve të tyre.

Në lidhje me këtë denoncim ka pasur disa kallëzime, të cilat janë trajtuar më lart, nga ku ka rezultuar se veprimet e subjektit nuk janë bërë objekt hetimi. Për më tepër, prokuror i çështjes

---

<sup>19</sup> Ankesa është paraqitur në IKP dhe ka ardhur në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2019.

nuk rezulton të ketë qenë subjekti, por subjekte të tjera rivlerësimi, për të cilat denoncuesit kanë bërë kallëzimet përkatëse.

### **90.3 Denoncim i shtetasit R.Z<sup>20</sup>**

Denoncuesi ankohet për subjektin dhe një subjekt gjyqtar, pasi sipas tij nuk i kanë dhënë të drejtën e përfitimit të ligjit për amnistinë nr. 22/2014. Sipas denoncuesit ai deklaroi se nuk ka përfituar amnistinë në kohën që është bërë bashkimi i dënimeve të marra. Në lidhje me këtë pretendim të shtetasit R.Z, subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 3.4.2023, ka sqaruar se: *“Në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër është paraqitur kërkesa me objekt “Uljen e dënimit në masën prej 1 viti”, për shkak të zbatimit të ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”. Pas hedhjes në short kjo çështje është shqyrtuar nga gjyqtari S.Sh. Pas marrjes së njoftimit (nëpërmjet fletëhirrjes) unë si prokuror i ekzekutimeve kam përfaqësuar organin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga provat dhe aktet e shqyrtuara dhe administruara gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ka rezultuar se: Me vendimin nr. \*\*, datë 15.1.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit R.Z për veprat penale “Vrasje me dashje” (e mbetur në tentativë) dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76-22 dhe 278/2 të Kodit Penal dhe pas bashkimit të dënimeve (neni 55-56 i Kodit Penal) dhe aplikimit të gjyqimit të shkurtuar (neni 406/1 i Kodit Penal) e ka dënuar përfundimisht me 6 vite e 8 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 20.3.2014. Ndërkohë, me vendimin nr. \*\*, datë 20.11.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit R.Z për veprat penale “Vrasje me dashje” (e mbetur në tentativë) dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76-22 dhe 278/2 të Kodit Penal dhe pas bashkimit të dënimeve (neni 55-56 i Kodit Penal) dhe aplikimit të gjyqimit të shkurtuar (neni 406/1 i Kodit Penal) e ka dënuar përfundimisht me 10 vite burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 15.12.2011.*

*Me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 25.5.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bashkimin e dënimit penal me 10 vite burgim të dhënë me vendimin nr. \*\*, datë 20.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ndaj të dënuarit R.Z, me dënimin penal 5 (pesë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim të dhënë me vendimin penal të formës së prerë nr. \*\*, datë 15.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë ndaj të dënuarit R.Z, duke i caktuar një dënim të vetëm prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh e 8 (tetë) muaj burgim. Pikërisht, në pjesën arsyetuese të vendimit nr. \*\*\* akti, datë 25.5.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se: Në bashkimin e dënimit me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim, dhënë me vendimin nr. \*\*, datë 15.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me atë prej 10 (dhjetë) vitesh, dhënë me vendimin nr. \*\*, datë 20.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, çmon të aplikojë në kuadrin e bashkimit të dy dënimeve penale atë të bashkimit aritmetik të dënimeve, të kërkuar nga ana e prokurorit të seancës, konkretisht nga ana e organit të procedurës në vendimin e 2-të i është ulur të dënuarit 1 (një) vit burgim nga vuajtja e dënimit për shkak të përfitimit nga amnistia, neni 4, pika 3 e ligjit nr. 22/2014. Më poshtë vazhdon: Gjykata konkludon se kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të dënuarin R.Z, për të caktuar si dënim përfundimtar, në bashkim të dënimeve, 15 (pesëmbëdhjetë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim është e bazuar në dispozitën konkrete. Ky vendim (i bashkimit të dënimeve) është ankimuar nga i dënuari R.Z në Gjykatën e Apelit Tiranë. Me*

---

<sup>20</sup> Nr. \*\* prot., datë 30.3.2022.

vendimin nr. \*\*\*, datë 20.12.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\* akti, datë 25.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me këtë ndryshim: Caktimin e një dënimi të vetëm për t'u ekzekutuar ndaj të dënuarit R.Z, prej 11 (njëmbëdhjetë) vitesh e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Vendimi i bashkimit të dënimeve është vënë në ekzekutim nga Zyra e Ekzekutimeve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pikërisht, në pjesën arsyetuese të vendimit Gjykata e Apelit Tiranë ka konstatuar se në shkaqet e ankimit nuk është pretenduar, diskutuar apo trajtuar ulja e dënimit prej 1 viti në bazë të ligjit nr. 22/2014, "Për dhënie amnistie", pasi, së pari, një gjë e tillë nuk ka qenë në shkaqet e ankimit të ngritur nga i dënuari dhe, së dyti, Gjykata e Apelit ka argumentuar se ndaj të dënuarit nuk duhej bërë bashkimi aritmetik i dënimeve prej 5 vjet e 8 muaj + 10 vjet = 15 vjet e 6 muaj, por bashkimi i dënimeve sipas parimit të dënimit më të rëndë të shtuar prej 5 vjet e 8 muaj + 10 vjet = 11 vjet e 6 muaj. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të akteve të sipërcituara, nga ana ime si prokuror është konstatuar se ulja e dënimit prej 1 (një) viti për shkak të zbatimit të ligjit nr. 22/2014, "Për dhënie amnistie" i është llogaritur një herë kërkuarit R.Z, pasqyruar në vendimin nr. \*\* akti, datë 25.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.12.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë (në lidhje me bashkimin e dënimeve dhe vetëm për sa i përket mënyrës së bashkimit nga ai aritmetik në atë të dënimit më të rëndë të shtuar) dhe nuk ka vend për uljen sërish me 1 vit burgim për shkak të zbatimit të ligjit nr. 22/2014, "Për dhënie amnistie".

Me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) datë 4.11.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesës së të dënuarit R.Z, me objekt "Ulje dënimi për shkak të ligjit nr. 22/2014".

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuari R.Z për në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Me vendimin nr. \*\*\* datë 12.5.2021, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*) datë 4.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër".

Sqarojmë se çështjet me objektin e sipërpërmendur vihen në lëvizje me kërkesën e të dënuarit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe unë si prokuror i ekzekutimeve kam marrë pjesë në gjykim si përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nga unë nuk disponohet fashikull, pasi janë çështje që fillojnë mbi bazën e kërkesës së të dënuarit drejtpërdrejt në Gjykatë. Rrjedhimisht janë akte që administrohen nga Gjykata dhe unë nuk disponoj dokumentacion. Në këtë gjykim kam përfaqësuar Prokurorinë dhe kam mbajtur qëndrimin përkatës pasi jam njohur në seancë me kërkesën dhe provat e të dënuarit. Seancat gjyqësore janë zhvilluar me regjistrim audio dhe çdo qëndrim i imi si përfaqësues i Prokurorisë është i regjistruar.

Në këto lloj çështjesh nuk kryhen veprime procedurale nga Prokuroria, aq më tepër në rastet kur vendimi përfundimtar është "rrëzim kërkesë". Në rastet kur vendimi i Gjykatës është "pranim kërkesë", atëherë për prokurorin lind detyrimi ligjor që pas administrimit të vendimit të procedohet me vënien në ekzekutim, çfarë do të thotë lëshimi i urdhrin të ekzekutimit përkatës dhe duke krijuar kështu fashikullin e prokurorit pranë Zyrës së Ekzekutimeve".

Subjekti ka depozituar vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) datë 4.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi dhe marrë formë të prerë me vendimin nr. \*\*\* datë 12.5.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykata në këtë vendim ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasit R.Z.

Në përfundim, në lidhje me këtë ankesë nuk konstatohet shkelje nga ana e subjektit, për sa kohë ka edhe një vendim gjykate të formës së prerë.

Nga ana e Komisionit, bazuar në dosjen e ankesës, nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

**91.** Në datën 26.9.2023, në orën 18:13, në adresën e *email*-it të anëtarëve të trupit gjykues, si dhe përfaqësuesve të ONM-së ka ardhur një denoncim nga shtetasja A.D. Në tekstin shoqëruar të *email*-it, denoncuesja pretendon se subjekti, nën kërcënimin e armëve të ftohta kërcënon dhe kanos qytetarin në mes të qytetit. Denoncuesja ka bashkëlidhur një video ku duket qartë subjekti, i ulur në makinë, me një thikë dhe një dorezë grushtuese që i drejtohet dikujt me fjalët: “*O trim, hajde këtu...*”. Në sfond dëgjohet e qeshura e një vajze, ndërsa subjekti shfaqet gjithashtu duke buzëqeshur.

**91.1** Meqenëse ky denoncim është administruar disa orë përpara seancës, trupi gjykues u njoh dhe e vlerësoi përpara se të fillojë seanca, duke vendosur t’ia vërë në dispozicion subjektit dhe t’i japë atij kohën e nevojshme për të dhënë shpjegime.

**91.2** Në shpjegimin e dhënë në seancë, si dhe në përgjigje të pyetjeve që u bënë nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti ka sqaruar fillimisht rrethanat e ngjarjes. Ai ka pretenduar se ngjarja ka ndodhur në vitin 2017. Ai ndodhej në makinën e tij së bashku me bashkëshorten, e cila ka regjistruar videon, si dhe vajzën e tij, zëri i së cilës dëgjohej duke qeshur. Subjekti ka sqaruar se ka qenë një ngjarje intime brenda familjes, një shaka që po bënte për të ngritur humorin e vajzës, e cila kishte pasur një ditë/ngjarje jo të këndshme dhe ai kishte dashur ta bënte për të qeshur, duke u hequr si një personazh i filmave vizatimorë.

**91.3** Subjekti ka pretenduar se kjo ngjarje nuk ka pasur lidhje me asnjë qytetar dhe nuk ka pasur elemente kanosjeje ndaj askujt.

**91.4** Në përgjigje të pyetjeve të drejtuara, subjekti ka sqaruar se këto armë të ftohta i ka marrë për pak minuta nga dhoma e provave të prokurorisë ku punonte. Ndërkohë që ai ka pretenduar se të tilla mjete mund të bliheshin në atë kohë në treg lirisht.

**91.5** Trupi gjykues gjatë vendimmarrjes e diskutoi këtë çështje në veçanti, duke pasur parasysh dy elemente, mbajtjen e armëve të ftohta dhe nxjerrjen e tyre nga dhoma e provave të prokurorisë. Duke qenë se ngjarja ka ndodhur në vitin 2017, pra pas periudhës objekt rivlerësimi, zhvillohet në një mjedis të mbyllur, privat, siç është makina e subjektit, vendosi që ta dërgojë këtë denoncim pranë ILD-së, me qëllim hetimin e mëtejshëm në funksion të mundësisë për shkeljen e etikës nga prokurori.

**91.6** Në lidhje me këtë sjellje, e cila vlerësohet se nuk përputhet me sjelljen dhe etikën e një magjistratit, Komisioni konstaton se ajo është kryer jashtë ushtrimit të profesionit, në automjetin e subjektit, në prani të familjarëve të tij.

**91.7** Në analizim të të gjitha rrethanave të mësipërme, si dhe fakteve të parashtruara nga subjekti, të dhënat e rezultuara nga hetimi i çështjes janë të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti ndodhet në kushtet e “cenimit të besimit të publikut” dhe ndaj tij duhet të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra. Komisioni vlerëson se kjo sjellje e subjektit duhet parë dhe vlerësuar lidhur me kriteret e vlerësimit në raport me gjetjet e rezultuara nga hetimi për kriterin e pasurisë, të figurës dhe atë të aftësive profesionale. Realizimi i videos nga ana e subjektit në një ambient të mbyllur, në prani të familjarëve të tij, pavarësisht se është një veprim që nuk

përputhet me sjelljen e magjistratit, në kushtet kur nuk rezultuan problematika të tjera serioze në të tria kriteret, është e pamjaftueshme për Komisionin për të aplikuar nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar se sjellja e subjektit dhe mungesa e kujdesit të treguar prej tij nuk duhet të mbetet pa u trajtuar. Ligji nr. 84/2016 nuk ka të parashikuar dispozita ligjore në lidhje me shkelje të tilla të kryera nga ana e subjektit, pasi me ligj janë kompetencë e një institucioni tjetër.

**91.8** Për këtë arsye, konstatimet e Komisionit në lidhje me sjelljen e subjektit të rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit, të parashikuara në nenin 103 e vijues të ligjit nr. 96/2016, do t'i përcillen për kompetencë ILD-së për vlerësime të mëtejshme, për të gjykuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Agron Bushati.

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

**92.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

**93.** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

**94.** Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara nga denoncimi i datës 26.9.2023 nuk ngrihen në nivelin e shkakut, që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pikat 4 dhe 5 të këtij ligji.

**95.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 dhe 4 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Bushati, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent (ILD) për vlerësim denoncimin e ardhur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 26.9.2023, bazuar në nenin 103/e të ligjit nr. 96/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 27.9.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
**Kryesues**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*